



**Republika e Kosovës – Republika Kosova**  
**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashitresa**  
*Izborni Panel za Žalbe i Predstavke*

**Anr. 182/2014**

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashitresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Ferit Osmani Kryesues, Rafet Haxhaj dhe Xhevdet Abazi anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e parashtruar nga Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Pejë, paraqitur kundër Xhavit Haliti kandidat për deputet në Kuvendin e Republikës së Kosovës nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Pejë, për shkak të vendosjes të banerit mbi rrugë publike për Zgjedhjet e Parakohshme Parlamentare, në seancën e panelit të mbajtur me 08.06.2014, mori këtë:

**VENDIM**

**Miratohet** si e bazuar ankesa e parashtruar nga Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), ndërsa Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Pejë i shqiptohet dënimi më gjobë në vlerë prej 1800 (njëmijë e tetëqind) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e pranimit të këtij vendimi.

**Arsyetim**

Me datën 05.06.2014, PZAP-i ka pranuar një ankesë nga Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) me seli në Pejë, në të cilën pretendohet se me datën 04.06.2014 rreth orës 10:00 Shtabi Zgjedhor i LDK-së në Pejë ka vërejtur se mbi rrugën publike afër stadiumit të qytetit në Pejë, PDK-ë kishte vendosur banerin e kandidatit për deputet në Kuvendin e Republikës së Kosovës Xhavit Haliti. Andaj me këtë veprim është bërë shkelje e nenit 4.1 pika b) të Rregullës Zgjedhore nr. 11/2013 të Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike Mbështetësit e Tyre dhe Kandidatët, pretendohet në ankesën e LDK-së.

Parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur si provë një fotografi nga vendi i ngjarjes si dhe deklaratën e një dëshmitarit.

PZAP-i, në kuptim të nenit 4, paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, dhe nenit 120 paragrafi 1 pika a) të LZP-së, PZAP-i me datë 05.06.2014 e informoi subjektin politik PDK, për ankesën që është bërë kundër këtij subjekti politik dhe ka kërkuar që të përgjigjet në Kërkesën për Përgjigje dhe Urdhër për të Ndërmarr Masat Përmirësuese lidhur me ankesën deri më datë 06.06.2014, në ora 17:00.

Sipas afatit të caktuar PZAP-i pranoi përgjigjen në ankesë nga subjekti politik PDK, me të cilën theksohet se në momentin e njoftimit për ankesën që është bërë ndaj këtij subjekti aktivistet e PDK-së, kanë larguar menjëherë banerin e kandidatit Xhavit Haliti, dhe si provë kanë bashkangjitur fotografinë në të cilën dëshmohet largimi i banerit në atë vend.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

**Ankesa është e bazuar**

Pretendimet nga parashtruesi i ankesës se subjekti politik PDK, ka vendosur banerin mbi rrugën publike në Pejë, janë të qëndrueshme ngase konstatohen nga fotografitë të cilat gjenden në shkresat e lëndës.

Për përcaktimin e lartësisë së gjobës të vendosur në dispozitiv të këtij vendimi PZAP-i, ka marrë parasysh faktorët në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

PZAP-i, mori parasysh të gjitha rrethanat si rënduese ashtu edhe rrethanat lehtësuese. Si rrethanë rënduese mori se subjekti i njëjtë politik ka marr pjesë edhe në zgjedhjet e kaluara dhe se konsiderohet se është e njoftuar me procesin zgjedhor. Ndërsa si rrethanë lehtësuese PZAP-i mori se subjekti politik PDK, pas marrjes së Kërkesës Përgjigje dhe Urdhër për të Ndërmarr Masa Përmirësuese nga PZAP-i, ka ndërmarr veprime të dukshme për evitimin e shkeljes duke e larguar banerin nga vendi ku pretendohet se ka ndodhur shkelja e supozuar.

PZAP-i, duke u bazuar në shkresat e lëndës konstatoi se subjekti politik PDK ka rënë në kundërshtim me nenin 4 paragrafi 1 pika b) të Rregullës Zgjedhore Nr.11/2013 dhe nenin 33 pika b) të LZP-së, i cili parashihet se *”Është e ndaluar vendosja e njoftimeve, pllakateve dhe posterëve ose vendosja e emrave të tyre ose e sloganeve në apo mbi rrugët publike gjatë fushatës zgjedhore “* duke pasur parasysh se nga ana e subjektit politik PDK është larguar baneri në fjalë, menjëherë pas marrjes së Kërkesës për Përgjigje dhe Urdhër për Ndërmarr Masat Përmirësuese nga PZAP-i, që nënkupton se është bërë evitimi i shkeljes së supozuar në bazë të provave të cilat i ka ofruar të bashkangjitura në Kërkesën për Përgjigje dhe Urdhër për të Ndërmarr Masa Përmirësuese e të cilat veprime kanë ndikuar në lartësinë e gjobës së shqiptuar, andaj në kuptim të nenit 120 paragrafi 1 pika c), si dhe nenit 118.1 të LZP-së, PZAP-i vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**

Anr. 182/2014 më datën 08.06.2014.



***Këshillë Juridike:***

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*